



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-2401/12
Dep.	Prot. No.
Nr. Haa.	Data
Proj. stranica 02	Datum 06-07-2012
Nr. pages	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenin 18 paragrafi 4, 8 dhe 12 të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenin 26 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **05.07.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit** në ushtrimin e funksionit publik, nga rastin nr. AKK-03-680/12, për z. **Ejup Qerimi** – Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Drejtor Ekzekutiv në Posten dhe Telekomin e Kosovës (PTK).
- II.** Agjencia do të kërkoj fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- III.** Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-680-12, për Zyrtarin e lartë, z. Ejup Qerimi – Anëtar i Bordit të Drejtorëve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht Drejtor Ekzekutiv i PTK-Sh.a., është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas trajtimit të rastit (Neni 8, pika 5, Ligji Nr.04/L-051), është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron njëkohësisht dy funksione të larta publike, një; funksionin prej zyrtari të lartë në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës – si Anëtar Bordi, në cilësinë e Përfaqësuesit Profesional të Punëdhënësve; dhe funksion tjetër, ate menaxhues, në Ndërrmarjen Publike, Posta dhe Telekomin i Kosovës – (PTK), si Drejtor Ekzekutiv. Menjëherë pas kësaj zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese për fillimin e hetimit të kësaj gjendje.

Pas shkreses njoftuese, zyrtari i lartë, z. Ejup Qerimi, Agjencisë kundër Korrupsionit (AKK), me datën 11.05.2012, i ka kthyer një shkresë zyrtare, që në AKK ka numër protokoli DPK/DPKI-03-1744/2012, në të cilën, Z.Qerimi, pretendon se, ushtrimi paralel i këtyre dy funksioneve të tij, nuk paraqesin konflikt interesi.

Agjencioni kundër korrupsionit ka trajtuar mirë argumentet e ofruara nga z.Qerimi, por megjithatë pikat e precizuara në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Ligji P.K.I. Nr. 04/L-051) kanë qenë ato që situatën e tillë e konsiderojnë konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, dhe prandaj, konform procedurës administrative për rastet e konfliktit të interesit që Agjencia i zbaton sipas Ligjit, zyrtarit të lartë, Ejup Qerimi, i është bërë edhe shkresa e dytë (24.05.2012) që njihet si “Paralajmërim”, me të cilën ai është njoftuar se; *konform ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit Nr.04/L-051, Neni 16, pika 1, ushtrimi i këtyre dy funksioneve paraqesin situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

Në këtë shkresë, nga zyrtari i lartë është kërkuar që brenda afatit të caktuar të vendosë se cilin funksion don ta mbaj, e nga cili funksion dëshiron të heq dorë, dhe për vendimin e tij ta njoftoi Agjencinë. (Neni 18 pika 7 e Ligjit Nr.04/L-051).

Zyrtari i Lartë, Z.Qerimi ka shprehë gatishmërinë të bashkëpunoj me Agjencinë për të zgjedhur këtë situatë, por edhe përkundër Paralajmërimit të Agjencisë dhe afatit të dhënë për të heq dorë nga njëri funksion, ai edhe më tutje vazhdon të ushtroj njëkohësisht këto dy funksione, si Anëtar i Bordit të Trustit Pensional të Kursimeve, në cilësinë e Përfaqësuesit Profesional të Punëdhënësve, në njerën anë, dhe Drejtor Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike “PTK” Sh.a. në anën tjetër, që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, (Nr.04/L-051, Neni 16, pika 1), konsiderohen të papajtueshme dhe paraqesin konflikt interesi.

II. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, “Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuar në paragrafin 1.1 ”.

Sipas Nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit, gjykata mund t’i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit.

III. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në web faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Shefit të Divizionit për P.K.I.
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

